



OSHEE
GROUP


LIDHJE E RE APLIKIM ONLINE

Ky website shërben dhe i vihet në dispozicion të gjithë personave të cilët duan një lidhje të re elektrike për banesën apo biznesin e tyre. Në këtë manual do të shpjegohet hap pas hapi e gjithë procedura e regjistrimit/logimit, mënyrës së aplikimit dhe përdorimit të website.

I. REGJISTRIMI/LOGIMI NË WEBSITE

💡 Aksesoni website sipas url-së [...](#)

1) Nëse nuk jeni i regjistruar, ju duhet të regjistroheni duke ndjekur udhëzimet si më poshtë:



The image shows a registration form for OSHEE GROUP. The form is titled "Regjistrimi i Lidhjes së re" and asks "Je i regjistruar në platformë?" with a link to "Hyrtani". The form fields are: Emri, Mbiemri, NID, Nr. Telefoni: +355, and Email. A "Vazhdo" button is at the bottom. Below the button, there is a disclaimer: "Duke klikuar Vazhdo më sipër, ti pranon që ke lexuar, kuptuar dhe pajtohesh me Politikën e Privatësisë, Termat dhe kushtet e përdorimit Politikës së rimbursimit". The footer says "© 2024 OSHEE GROUP SH.A". To the right of the form, there is a specimen card from the "REPUBLIKA E SHQIPERISE REPUBLIC OF ALBANIA" with a red box around the ID number "105101999Q". A red arrow points from this ID number to the NID field in the registration form.

Siç shihet dhe në figurë kjo është forma e regjistrimit ku ju duhet të vendosni të dhënat e kërkuara në secilën fushë, në mënyrë që të regjistroheni me sukses në website.

Të dhënat e nevojshme për regjistrim janë:

💡 Të dhënat personale (**Emër, Mbiemër**)

💡 Numri i **ID** (Numri personal i identifikimit)

💡 Numri i **Telefonit** (**+3556XXXXXXXX**). Në rast se nuk jeni rezident, vendoseni numrin me prefiksin e shtetit përkatës.

💡 **Email**


2) Në rastin kur ju jeni i regjistruar në website klikoni fillimisht “**Hyr Tani**” dhe më pas identifikohuni duke plotësuar fushat:



Email



NID (Numri personal i identifikimit)



***Kujdes**, *Email* dhe *NID* duhet të plotësohen me të dhënat që keni plotësuar në regjistrimin e mëparshëm.

II. PLOTËSIMI I FORMULARIT TË APLIKIMIT

Pasi keni kryer regjistrimin ose identifikimin tuaj, do të shfaqet formulari i kërkesës për një lidhje të re elektrike. Më poshtë do të shpjegohet secila fushë dhe mënyra se si duhet të plotësohet, në mënyre që secili përdorues të kryej një kërkesë të saktë pa hasur probleme.

1) Në këtë pjesë të parë të formularit duhet të plotësohen të dhënat mbi adresën e lidhjes së re.



FORMA E REGJISTRIMIT TË LIDHJES SË RE
SHËNIM

Ju lutem të plotësohen të gjitha fushat në mënyrë korrekte dhe siguroni paraqitjen e dokumenteve të skanuara online për përfundim të mëtejshëm të regjistrimit të lidhjes së re.

Adresa e Lidhjes së Re


Rajoni	Qyteti/Fshati
Njësia Administrative	Numri i Ndërtesës
Numri i Hyrjes	Apartamenti
Adresa	

- 💡 Në fushën e parë me titull **Rajoni**, ndodhet një listë rajonesh ku secili përdorues duhet të zgjedhë rajonin në të cilin bëhet kërkesa për një lidhje të re elektrike.
- 💡 Në fushën **Qyteti/Fshati** përdoruesi duhet të zgjedhë qytetin apo fshatin në listen që do të shfaqet.
- 💡 E njëjta procedurë do të ndiqet dhe me fushën me titull **Njësia Administrative**.
- 💡 Fushat si **Numri i Ndërtesës**, **Numri i Hyrjes** dhe **Adresa** janë fusha të domosdoshme për tu plotësuar, ndërsa **Numri i Apartamentit** është fushë opsionale.

- 2) Në pjesën e dytë të aplikimit përdoruesi duhet të plotësojë **Detajet e Identifikimit** si në figuren e mëposhtme. Në këtë pjesë duhet të plotësoni të dyja fushat, pasi janë të domosdoshme për aplikimin tuaj

 Në fushën me titull **Mjeti i Identifikimit** përdoruesi duhet të zgjedhë llojin e identifikimit midis këtyre metodave të identifikimit:

- a. *Numër ID*
- b. *NIPT*
- c. *Jo Rezident*

 Në bazë të zgjedhjes që përdoruesi ka bërë në lidhje me mjetin e identifikimit duhet të plotësojë **Numrin Personal të Identifikimit**.

FORMA E REGJISTRIMIT TË LIDHJES SË RE

SHËNIM

Ju lutem të plotësohen të gjitha fushat në mënyrë korrekte dhe siguroni paraqitjen e dokumenteve të skanuara online për përpunim të mëtejshëm të regjistrimit të lidhjes së re.

Adresa e Lidhjes së Re

Rajoni	Qyteti/Fshati
Njësia Administrative	Numri i Ndërtesës
Numri i Hyrjes	Apartamenti
Adresa	

Detajet e Identifikimit

Mjeti i Identifikimit	Numri Personal i Identifikimit
-----------------------	--------------------------------

- 3) Në pjesën e tretë të aplikimit përdoruesi duhet të zgjedhi **Llojin e Furnizimit**. Në këtë kategori përdoruesi duhet të zgjedhi midis dy mundësive, nëse ai po e bën kërkesën si **Familjar** apo si **Biznes**. Kjo është një fushë e domosdoshme për tu plotësuar në mënyrë që formulari dhe kërkesa e përdoruesit të regjistrohet me sukses. Në varësi të zgjedhjes së kategorisë, do të shfaqen dhe fushat përkatëse që duhen plotësuar.

- a. Nëse përdoruesi është **Familjar** ai duhet të plotësojë **Detajet e Klientit** si:

 **Emër Mbiemer**


 **Atesi**

 **Numri I Telefonit**

Adresa Email


Datëlindja

- b. Nëse përdoruesi po aplikon si **Biznes**, përveç fushave të cilat u përmendën më sipër dhe siç shihen tek **Detajet e Klientit** në figurën e mëposhtme, përdoruesi duhet të vendosë dhe emrin e biznesit për të cilin po bën aplikimin.



The screenshot shows a web form with several sections. The 'Lloji i Furnizimit' section is at the top, followed by a 'Kategoria' dropdown menu. The 'Detajet e Klientit' section is highlighted with a red box and contains the following fields: 'Emri' and 'Mbiemri' (text inputs), 'Atësia' and 'Numri i Telefonit' (text inputs), 'Adresa Email' (text input), and a date field with the format 'mm/dd/yyyy' and a calendar icon. Below this is the 'Adresa e Faturimit' section with a checkbox labeled 'Adresa e faturimit ndryshe nga adresa e abonentit'. The 'Fuqia' section at the bottom contains 'KW' (text input), 'Fuqia e Kërkuar' (dropdown menu), 'Faza' (dropdown menu), and 'Voltazhi' (text input).

- 4) Në pjesën e katërt të aplikimit përdoruesi ka mundësinë të zgjedhë ose jo nëse adresa e faturimit është ndryshe nga adresa e abonentit, në varesi të situatës.



The screenshot shows the 'Adresa e Faturimit' section highlighted with a red box. It contains a checkbox labeled 'Adresa e faturimit ndryshe nga adresa e abonentit' which is checked. Below the checkbox are four text input fields: 'Adresa', 'Numri i Ndërtesës', 'Numri i Hyrjes', and 'Apartamenti'.

💡 Nëse përdoruesi zgjedh ta vendosi si opcion, duhet të plotësojë disa fusha të tjera si më poshtë:

- a. Adresa
- b. Numri i Ndertesës
- c. Numri i Hyrjes.

5) Në pjesën e pestë përdoruesi duhet të plotësojë detajet mbi fuqinë e energjisë elektrike që i duhet për lidhjen e re.

💡 Në fushën me titull **Fuqia e Kerkuar**, përdoruesi duhet të zgjedhi midis tre kategorive të fuqisë si:

- a. 0-20 KW
- b. 20-50 KW
- c. Mbi 50 KW

💡 Gjithashtu përdoruesit i duhet të zgjedhë midis dy opsioneve në fushën me titull **Faza** si: **I** dhe **III**.

💡 Në bazë të Fazës që përdoruesi zgjedh, fusha me titull voltazhi plotësohet në mënyrë automatike me vlerat respektive: për fazën **I** voltazhi ka vlerë 220V dhe për fazën **III** me vlerë **380V**.

Fuqia

KW 0 - 20

Faza Voltazhi

Dokumentat
Dokumentat duhet të ngarkohen në formatin: pdf, doc, docx, png, jpeg

6) Në pjesën e gjashtë të aplikimit përdoruesit i duhet të ngarkojë dokumentat e kërkuara në bazë të fuqisë së zgjedhur. Më poshtë do të shikoni listën e dokumentave që kërkohen për secilën kategori fuqie.

***Kujdes**, dokumentat duhet të ngarkohen në një nga formatet e kërkuara si: pdf, word doc. ose foto png, jpeg, në mënyrë që aplikimi të kryhet me sukses.



Fuqia 0-20 KW

Fuqia

KW: 0 - 20

Faza: Voltazhi:

Dokumentat

Dokumentat duhet të ngarkohen në formatin: pdf, doc, docx, png, jpeg

Vërtetimi i identitetit (Fotokopje karte identiteti ose pasaporte)	Ngarko
Vërtetim i pronësisë së objektit nëpërmjet dokumentave të rregjistrimit të pronësisë si : Akt shitje, akt dhurimi, akt ndarje prone të patundshme, kontratë qiraje, dokumentacioni përkatës për objektet që janë në proces legalizimi	Ngarko
Fotokopje e Certifikatës së rregjistrimit (për subjektet jofamiljare)	Ngarko
Genplani i vendndodhjes së objektit në shkallën 1:1000 (dy kopje), (të specifikuara koordinatat e gjurmës së objektit).	Ngarko
Deklaratë instalimi dhe protokoll tokëzimi, i lëshuar nga inxhinier elektrik i pajisur me licencë.	Ngarko



Fuqia 20-50 KW

KW: 20 - 50

Faza: Voltazhi:

Dokumentat

Dokumentat duhet të ngarkohen në formatin: pdf, doc, docx, png, jpeg

Vërtetimi i identitetit (Fotokopje karte identiteti ose pasaporte)	Ngarko
Vërtetim i pronësisë së objektit nëpërmjet dokumentave të rregjistrimit të pronësisë si : Akt shitje, akt dhurimi, akt ndarje prone të patundshme, kontratë qiraje, dokumentacioni përkatës për objektet që janë në proces legalizimi	Ngarko
Fotokopje e Certifikatës së rregjistrimit (për subjektet jofamiljare)	Ngarko
Projekti elektrik i objektit, i miratuar nga organet kompetente sipas legjisllacionit në fuqi	Ngarko
Planvendosja e të gjitha pajisjeve në objekt.	Ngarko
Licenca e inxhinierit elektrik, i cili ka bërë projektin elektrik të objektit.	Ngarko
Genplani i vendndodhjes së objektit në shkallën 1:1000 (dy kopje), (të specifikuara koordinatat e gjurmës së objektit).	Ngarko
Deklaratë instalimi dhe protokoll tokëzimi, i lëshuar nga inxhinier elektrik i pajisur me licencë.	Ngarko
Raporti i detajuar inxhinierik në lidhje me projektin dhe përlogaritjen e të dhënave, i kryer nga inxhinier elektrik i pajisur me licencë.	Ngarko



Fuqia Mbi 50 KW

Dokumentat
Dokumentat duhet të ngarkohen në formatin: pdf, doc, docx, png, jpeg

Vërtetimi i identitetit (Fotokopje karte identiteti ose pasaporte)	<input type="button" value="Ngarko"/>
Vërtetim i pronësisë së objektit nëpërmjet dokumentave të regjistrimit të pronësisë si : Akt shitje, akt dhurimi, akt ndarje prone të patundshme, kontratë qiraje, dokumentacioni përkatës për objektet që janë në proces legalizimi	<input type="button" value="Ngarko"/>
Fotokopje e Certifikatës së regjistrimit (për subjektet jofamiljare)	<input type="button" value="Ngarko"/>
Projekti elektrik i objektit, i miratuar nga organet kompetente sipas legjislationit në fuqi	<input type="button" value="Ngarko"/>
Planvendosja e të gjitha pajisjeve në objekt.	<input type="button" value="Ngarko"/>
Licenca e inxhinierit elektrik, i cili ka bërë projektin elektrik të objektit.	<input type="button" value="Ngarko"/>
Genplani i vendndodhjes së objektit në shkallën 1:1000 (dy kopje), (të specifikuar koordinatat e gjurmës së objektit).	<input type="button" value="Ngarko"/>
Deklaratë instalimi dhe protokoll tokëzimi, i lëshuar nga inxhinier elektrik i pajisur me licencë.	<input type="button" value="Ngarko"/>
Raporti i detajuar inxhinierik në lidhje me projektin dhe përlllogaritjen e të dhënave, i kryer nga inxhinier elektrik i pajisur me licencë.	<input type="button" value="Ngarko"/>
Leja e ndërtimit të objektit	<input type="button" value="Ngarko"/>
Grafiku i ngarkesës elektrike	<input type="button" value="Ngarko"/>
Relacion analitik për vlerësimin e cosØ	<input type="button" value="Ngarko"/>





- 7) Në pjesën e fundit të aplikimit përdoruesi duhet të zgjedhë njëren nga metodat e mëposhtme për marrjen e komunikimit si dhe mund të vendosi shënime në rast se ka ndonjë të tille.

Fuqia

Marrja e Njoftimit

Postë SMS Email

Shënime nga abonenti

-  Pasi të gjitha të dhënat janë plotësuar saktësisht sipas instruksioneve të mësipërme, përdoruesi duhet të shtypi butonin ***Vazhdo***.
-  Nëse të gjitha të dhënat janë plotësuar sic duhet përdoruesit do ti paraqitet një mesazh në ngjyrë jeshile dhe një kod, me të cilin përdoruesi mund të ndjekë të gjithë procedurën e kërkesës së regjistruar.
-  Në rast se përdoruesit i ndodh ndonjë gabim gjatë dërgimit të kërkesës, një mesazh në ngjyrë të kuqe do ti shfaqet sipër butonit ***Vazhdo***.
-  Nëse e gjen të pamundur për ta dërguar aplikimin, duhet ta rishikojë dhe një herë aplikimin nëse ka ndonjë fushë të paplotësuar, e cila do të tregohet me mesazh poshtë fushës përkatëse.

III. LISTA E APLIKIMEVE

Në menunë e mëposhtme përveç *Formularit të Aplikimit* për lidhje të re elektrike, ndodhet dhe *Lista e Aplikimeve*. Në këtë faqe përdoruesi do të gjejë listën e plotë të aplikimeve të bëra nga ai, për lidhje të re elektrike.



Nëse përdoruesi nuk ka bërë asnjë kërkesë do të shfaqet faqja si mëposhtë:



Nuk u gjet asnjë aplikim

Shko tek formulari për të aplikuar për një lidhje të re


[Formulari](#)





Nëse përdoruesi ka bërë një kërkesë për lidhje të re dhe ka marrë kodin e kërkesës, përdoruesi në faqen *Lista e Aplikimeve* do të gjejë listën e aplikimeve të bëra dhe detajet mbi kërkesat.



Kodi	Kategoria	Data	Fuqia	Voltazhi	Statusi	Afati Ligjor	Kontrata	Preventivi	Historiku
LR000000071	Familjar	2024-02-06	0 - 20	220v	Në Pritje	20 Dite			 Detajet

U gjet një 1 rekord < 1 >

Tek *Detajet e Kërkesës* do të shfaqet:


- Kodi** i kërkesës
- Kategoria**, me të cilën përdoruesi ka kryer kërkesën,
- Data** në të cilën është bërë kërkesa
- Fuqia**
- Voltazhi**
- Afati Ligjor**
- Statusi**, i cili tregon se në cilin status ndodhet kërkesa juaj



Për më tepër informacion rreth aplikimit shtypni ikonën që ndodhet poshtë **Historikut**.


IV. HISTORIKU

 Nëse **Statusi** është *Në Pritje të Informacionit*, historiku do të shfaqet si më poshtë.




Voltazhi	Statusi	Afati Ligjor
220v	Në Pritje	20 Dite

Në pritje të informacionit


 Më poshtë është prezantuar një shembull se si duket historiku pas disa fazash nga aplikimi për një lidhje të re.




Afati Ligjor	Statusi
ratës	20 Ditë
2024-02-13	Verifikimi në Terren
	Shënime: Grupi i punës po bën verifikimet në terren
2024-02-13	Në Pritje të Informacionit
	Shënime: Ju lutem plotësoni informacionet dhe dokumentacionet e nevojshme për trajtimin e kërkesës tuaj!

 Kur statusi është *Në Pritje të Informacionit*, duhet të plotësoni dokumentacionin e kërkuar nga OSHEE, i cili do të komunikohet tek *Shënimet*.

2024-02-13 	
Statusi	Verifikimi në Terren
Shënime	Grupi i punes po ben verifikimet ne terren
2024-02-13 	
Statusi	Në Pritje të Informacionit
Shënime	Ju lutem plotesoni informacionet dhe dokumentacionet e nevojshme per trajtimin e kerkeses tuaj!

 Ju mund të shtoni dokumenta apo të modifikoni detaje nga aplikimi juaj duke shtypur butonin *Detajet* si në tabelen më poshtë:





Përdoruesit do ti shfaqet i njejt formular, por me detajet e plotesuara në momentin e aplikimit dhe duhet të bëjë modifikimet e kërkuara nga OSHEE tek pjesa e dokumentacionit si dhe të ngarkojë **Mandatin** (*I cili ngarkohet në këtë fazë të aplikimit*).

Dokumentat
Dokumentat duhet të ngarkohen në formatin: pdf, doc, docx, png, jpeg

Vërtetimi i identitetit (Fotokopje karte identiteti ose pasaporte)	Ngarko Vërtetim Identiteti
Vërtetim i pronësisë së objektit nëpërmjet dokumentave të regjistrimit të pronësisë si : Akt shitje, akt dhurimi, akt ndarje prone të patundshme, kontratë qiraje, dokumentacioni përkatës për objektet që janë në proces legalizimi	Ngarko Vërtetim Pronësie
Fotokopje e Certifikatës së regjistrimit (për subjektet jofamiljare)	Ngarko Certifikatë Regjistrimi
Genplani i vendndodhjes së objektit në shkallën 1:1000 (dy kopje), (të specifikuara koordinatat e gjurmës së objektit).	Ngarko Genplani
Deklaratë instalimi dhe protokoll tokëzimi, i lëshuar nga inxhinier elektrik i pajisur me licencë.	Ngarko Deklaratë Instalimi

Mandati
Dokumentat duhet të ngarkohen në formatin: pdf, doc, docx, png, jpeg

[Ngarko Mandatin](#) [Ngarko](#)



Historiku i mëposhtëm tregon të gjitha statuset hap pas hapi se si do te procedohet pas secilit status. Së fundmi kur statusi është **Lidhja e Kontratës**, kontrata juaj është lidhur dhe regjistruar dhe kjo procedurë është përfunduar me sukses.

2024-02-13	✓
Statusi	Lidhja e Kontratës
Shënime	Kontrata juaj është regjistruar me këtë kontratë: AL12324567. Bashkelidhur gjendet kopje e kontratës!
2024-02-13	✓
Statusi	Instalimi i Matësit
Shënime	Ekipi instaloi matësin pranë objektit tuaj!
2024-02-13	✓
Statusi	Mandati i Pagesës
Shënime	Mandati juaj i pagesës ndodhet në dokumentacionin bashkelidhur!
2024-02-13	✓
Statusi	Preventivi
Shënime	Pika juaj e lidhjes



Për çdo pyetje apo problematikë, ju lutem kontaktoni në adresën e Email ose numrin e kontaktit të mëposhtëm:

EMAIL:

NR KONTAKTI: